



Gazeta Nr 2 e projektit: *Heritage is Our Brand. Tiranë, Dhjetor 2025*

Projekti “Heritage is Our Brand”

E lashtë sa gurët e saj, që nga antikiteti e deri me sot, Shqipëria ka ruajtur gjuhën, zakonet dhe shpirtin e lirë – një trashëgimi që duhet t'ia përcjellim brezave që vijnë. Trashëgimia është marka jonë, është ajo që na dallon, që na jep identitet dhe na bën krenar për rrenjët tona. Ky projekt, i financuar nga [Bashkimi Evropian](#) dhe zbatuar nga [DMO Albania](#) dhe [EU Policy Hub](#), synon të ndërgjegjësojë të rinjtë tanë për të njohur dhe ruajtur trashëgiminë shpirtërore. Me shumë rreth [projektit](#).



Shpallen fituesit e granteve të vogla

15 ide fituese do të financohen nga projekti “Heritage is our brand” në kuadrin e skemës së granteve të vogla, bazuar mbi 40 histori frymëzuese të trashëgimisë sonë jomateriale. Filma të shkurtër, instalacione, animime, sfiata, teatro, koncerte e dokumentarë janë produktet artistike që krijohen nga projekti. Njihuni me [fituesit](#)



Tryezë: Fuqia e regjimitarisë në ruajtjen e trashëgimisë



Ky ishte titulli i tryezës së diskutimit të zhvilluar në Hotel Tirana International, në kuadër të projektit “Heritage is Our Brand”. Në tryezë u prezantua botimi me 40 histori unike të projektit të cilat tregojnë për vlerat e karakterit dhe jetës së shqiptarëve në shekuj. E pranishme ishte zv. ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, znj. Lira Pipa, e cila vlerësoi rëndësinë e këtij projekti. [Më shumë](#)

Botimi “Heritage is Our Brand”



40 histori unike të trashëgimisë tonë: nga Teuta- mbretresha e deteve; mbreti Gent dhe luja çudibërëse; inagurimi i amfiteatrit të Durrësit; Argea që lironte skllëvërit në Butrint; Kërcimi i Nimfave në Apolloni; E bukura e dheut në Seferan; Maximus legjionari i Scampis; Ilirët dhe vera e tyre Balisca; Shqiponjat e Arbrit; Beja në gur; Udhë e Krushqve; Dhurata e Kostandinit- e diela pushim; historia e Kodikëve të Beratit; etj. Këto e plot të tjera në botimin unik “Heritage is Our Brand” me regjitarit të bazuara në fakte historike. Botimi i prodhuar në kuadër të projektit do shpërndahet në Institucione publike dhe akademike. [Më shumë](#)

3 sesione informuese, 100 artistë e organizata

Projekti “Heritage is Our Brand”, zhvilloi 3 sesione informuese në Shqipëri për të informuar organizatat, artistët dhe grupet e interesit lidhur me rregullat e aplikimit. Më 18 Shtator u zhvillua sesioni i parë në Tiranë, më 24 Shtator në Shkodër dhe më 30 Shtator në Korçë.

Korçë



Tiranë



Shkodër



Mbi 230 aplikime për grantet e vogla

Më 15 tetor përfundoi afati i aplikimit për skemën e granteve të vogla të projektit “Heritage is our brand”. Mbi 230 aplikime nga gjithë Shqipëria, ide të mrekullueshme mbi praktika të trashëgimisë jomateriale që duhen mbrojtur. Ky numër i lartë i aplikimeve, tregoi se shqiptarët janë të ndjeshëm ndaj trashëgimisë dhe duan ta ruajnë për brezat e ardhshëm. [Më shumë](#)



Historitë e përzgjedhura



Shenjtëria e Kaprollit

Në një fshat të thellë malor, ku hijet e drurëve të vjetër mbulonin shtigjet dhe zëri i përrenjve përzihet me këngën e bilblit, jetonin njëzëz që e dëgjonin natyrën siç dëgjonin prindin a shenjtorin. Miti i shenjtërisë së kaprollit dhe tregimet popullore na kujtojnë se njeriu nuk është zot mbi natyrën, por pjesë e saj.

Më shumë

Dollia, bekimi i ngritur në kupë

Keni dëgjuar për Dollinë shqiptare? Duhet ta dini se nuk është thjesht një ngritje gote, por një rit i heshtur nderi, ku rakia (apo një pije tjetër tradicionale) shoqërohet me fjalë urimi e respekti, që dalin si një bekim i shpirtit.

Më shumë



Flija, shija e traditës

Në një ditë dimri, kur qielli mbulohet me re të trasha dhe dëbora fillon të bie me qetësi, në një shtëpi malësore të Kukësit fillon përgatitja për flinë. Oda është ngrohur me zjarrin që është ndezur qysh në mëngjes dhe rreth vatrës janë mbledhur gratë e shtëpisë.

Më shumë

Baliska, vera e ilirëve

Nga Plini, mësojmë se vera më e njohur ilire ishte balisca, prodhuar nga rrush Balisk që kultivohej në territorin e Dyrrahut, e eksportuar në Romë para periudhës së Augustit, dhe që vjetrohej shumë mirë. Ka studiues që mendojnë se vreshtat e Bordosë mund të kenë prejardhje nga ky varietet i Dyrrahut. Lexoni historinë për verën ilire, përmes dashurisë së Titusit dhe Dionës nga Dyrrahu, në platformën e projektit “Heritage Is Our Brand”.

Më shumë



Të gjithë artikujt e mësipërm i gjeni në platformën tonë edhe në anglisht: [www.albaniaheritage.com/en/](#)

Viti i dytë i projektit- Edukimi

2026	2026
Forum me mësuesit e Historisë dhe Letërsisë	Konkurs kombëtar me fëmijët
Event kombëtar me grupet e interesit	Fitues, certifikata, vlerësime

Projekti “Heritage is our brand” financohet nga Bashkimi Evropian. Përkrahjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian.



Na ndiqni në rrjetet sociale për më shumë informacione



Copyright (C) “2025” “DMO ALBANIA”. All rights reserved.

Our mailing address is:

“info@dmotalbania.al”/“www.albaniaheritage.com”

Want to change how you receive these emails?

You can update your preferences or unsubscribe

